

VENDIM
Nr. 648, datë 23.5.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E BRENDSHME, TË PRONËS NR. 842, ME EMËRTIMIN “SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË FIER, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR E PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pronës nr. 842, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, përjashtuar tri zyrat me sipërfaqe 118.90 (njëqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) m², që do të mbeten në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas formularit 1 (planvendosjes dhe planimetrisë) që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona nr. 842, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve” Fier, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar dhe t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të pronës të bëhet pas mbylljes nga Shtëpia Qendrore e Forcave të Armatosura, Tiranë, të veprimtarisë ekonomiko-financiare të filialit të saj, “Shtëpia e Ushtarakëve” në Fier dhe pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të magazinuara në këtë pronë.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha